



e Rahovecit

Në Krushë të Madhe filloi festivali «AgroFesta» 2025

Ky festival, që i dedikohet perimekulturës, është bërë shumë i rëndësishëm për të gjithë bujqit në Krushë të Madhe, Rahovec, por edhe më gjerë, i cili mbahet në kuadër të muajit të mërgimtarëve. AgroFesta është bërë një prej mënyrave më të mira për ta promovuar kultivimin e perimtarisë. Pra, bujqësia për rahovecasit, është kulturë dhe mënyrë jetese.



Çmimi: Dekorata për humanizëm "Dr. Ali Sokoli" i jepet Prof. dr. Samedin Haxhijaha, pas vdekjes

Në një ceremoni solemne, në prani të familjarëve, bashkëpunëtorëve dhe qytetarëve, Komuna e Rahovecit nderoi prof. dr. Samedin Haxhijaha me dekoratën për humanizëm «Dr. Ali Sokoli».

Kjo dekoratë u jepet atyre që me përkushtimin e tyre kanë ndikuar në përmirësimin e jetës dhe të kushteve të punës për njerëzit në nevojë. Shembulli i Prof. dr. Samedin Haxhijaha mbetet frymëzim dhe motivim për të gjithë ata që e shohin mjekësinë dhe humanizmin jo vetëm si profesion, por si mision jetësor.

